



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË

Nr. 5841 Prot.

Tiranë, me 26/11/2025

V E N D I M

Nr. 3, datë 26/11/2025

Gjykata e Lartë, e përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Sadushi	Kryetar
Ilir Panda	Zëvendëskryetar
Artur Kalaja	Anëtar
Ervin Pupe	Anëtar
Sokol Binaj	Anëtar
Albana Boksi	Anëtare
Sandër Simoni	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Gentian Medja	Anëtar
Margarita Buhali	Anëtare
Enton Dhimitri	Anëtar
Valbon Çekrezi	Anëtar

në datën 26/11/2025 u mbledh dhe mori në shqyrtim kërkesën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë me:

OBJEKT: Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë z. Asim Vokshi;

BAZË LIGJORE: Neni 139, pika 1, shkronja “dh” dhe pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 64 pika 6 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar),

pasi administroi aktet shoqëruese përkatëse,

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13188, datë 29.07.2021 “Për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë”, ka emëruar z. Asim Vokshi anëtar të Gjykatës së Lartë.

Me Vendimin nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, gjyqtari i Gjykatës së Lartë z. Asim Vokshi është zgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese me mandat të plotë 9-vjeçar.

Në datë 25.11.2025, gjyqtari z. Asim Vokshi bëri betimin përpara Presidentit të Republikës, fakt i cili shënon dhe fillimin e mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Në këto kushte, Gjykata e Lartë çmon se ndodhet përpara njërit prej rasteve të mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, të parashikuar nga neni 139 i Kushtetutës. Bazuar në nenin 139, pika 2 e Kushtetutës, mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Lartë, në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të nenit 139 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 64, pika 6 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar),

V E N D O S I:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë z. Asim Vokshi.
2. Kopje e këtij vendimi i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtar
Artur KALAJA

Anëtare
Albana BOKSI

Anëtar
Sandër SIMONI

Zëvendëskryetar
Hir PANDA

Anëtar
Ervin PUPE

Anëtar
Gentian MEDJA

Kryetar
Sokol SADUSHI

Anëtar
Sokol BINAJ

Anëtar
Medi BICI

Anëtare
Margarita BUHALI



Anëtar
Enton DHIMITRI



Anëtar
Valbon ÇEKREZI

